


bp. nr. 0401-4416
20.06.2022
TETOBO - TETOVE



Në bazë të nenit 30 paragrafi (1) alineja 2, paragrafi (3) dhe paragrafi (5), neni 48 dhe 49 i Ligjit për rëpunës Administrativ ("Gazeta zyrtare e R.M nr.27/2014, 199/2014, 48/2015, 154/2015, 5/2016, 142/2016, 5/2016 dhe 11/2018) dhe "Gazetes zyrtare të RMV-së" nr. 6p.275/19 dhe 14/20, në përputhje me Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e konkursit të brendshëm, mënyrën e parqitjes së fletëaplikimit për avancim, mënyrës së zbatimit të procedurës për seleksionimit dhe intervistës, mënyrës së rangimit në nivele dhe numrit maksimal të pikëve nga procedura e seleksionimit dhe varësisht nga kategoria e vendit të punës në të cilën është parqitur kandidati në konkursin e brendshëm (Gazeta zyrtare e R.M-se" nr.11/2015 dhe 35/2018), Institucioni Nacional Galeria e Arteve -Tetovë shpall:

KONKURSI TË BRENDSHËM NR. 01/2022

Për avancimin e rëpunësve administrativ në Institucioni Nacional "Galeria e Arteve"-Tetovë

Institucioni Nacional "Galeria e Arteve"-Tetovë, shpall Konkurs të brendshëm për avancimin e tre (3) rëpunësve administrativ në afat të pacaktuar në vendet e punës në vijim:

1. KUL. 0102 B01 001 Udhëheqës i sektorit administrativ për gëshje juridike dhe burimet njerzore - 1 realizues
2. KUL 0102 B02 001. Udhëheqës i njesisë finasiare dhe kontabilitet shifra e vendit-1 realizues
- 3.KUL 0102 B02 006. Udhëheqës i njesisë për marketnig-1 realizues

Kushtet e veganta:

- Niveli dhe lloji i arsimimit: niveli i kualifikimit VII 2 sipas kornizës Magedonase të kualifikimeve dhe kredi të arritura 180 ose 240, sipas ECVEF ose MKCOO.,.

Kompetencat e veganta të punës:

- Njohja në mënyrë aktive e njërës nga tre gjuhët më të përdorura në Unionin Evropian (anglisht, gjermanisht ose frëngjisht)
- Njohja në mënyrë aktive e programeve kompjuterike për punë në zyrë.

Përvoja në marrëdhënie pune:

- Sëpaku tre vite përvojë pune në profesion.

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i Republikës së Magedonisë;
- Të jetë i moshës madhore;
- Të jetë i aftë psiko fizikisht për ushtrimin e të drejtave dhe detyrimeve;
- Në mënyrë aktive të zotëroj gjuhën magedonase dhe gjuhën shqipe;
- Me aktgjykim të plotë fuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim, ndalesë për ushtrim të profesionit, vepimtarisë dhe detyrës;
- Të jetë i vlerësuar me "A" ose "B" dy vitet paraprake;
- Të jetë në vendin e punës në nivel më të ulët, respektivisht të mos jetë në kategorinë e njëjtë të vendit të punës për të cilin është hapur konkursi.